



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT  
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

# RAPORT

MBI

MONITORIMIN E FONDEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN  
JANAR – DHJETOR 2024,  
PËR KOLEGJIN E POSAÇËM TË APELIMIT

SHKURT 2025

1

## PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....
2. Raporti i shpenzimeve faktike për vitin 2024 .....
  - 2.1 Informacion mbi volumin dhe madhësinë e ndryshimit të buxhetit.....
  - Analiza financiare analitike .....
  - 2.1.1 Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600).....
  - 2.1.2 Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601).....
  - 2.1.3 Shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera (llogaria ekonomike 602).....
  - 2.1.4 Shpenzimet kapitale (231).....

## 1 HYRJE

Kolegji i Posaçëm i Apelimit është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si një ndër tri institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kolegji si organi i vetëm gjyqësor, gjatë mandatit të tij 9-vjeçar, ka kompetencë të shqyrtojë ankimet ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për çështjet e rivlerësimit, si dhe juridiksion disiplinor, në përputhje me përcaktimet e nenit 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Referuar nenit 179/b, pika 5 të Kushtetutës, Kolegji funksionon pranë Gjykatës Kushtetuese, si kolegji i dytë i saj. Gjyqtarët e Kolegjit, referuar pikës 3, të nenit C, të Aneksit të Kushtetutës, gjatë mandatit të tyre gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Për të përmbushur detyrat e ngarkuara nga Kushtetuta dhe ligji, Kolegji mbështetet nga Njësia e Shërbimit Ligjor dhe punonjësit administrativë.

**Misioni i Kolegjit është:** *“Përmbushja e funksioneve dhe kompetencave ligjore për garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi”*. Kolegji i Apelimit funksionon me një program të vetëm buxhetor, me emërtesën: “Veprimtaria e Apelimit të Rivlerësimit Kalimtar”.

**Përshkrimi i programit:** *“Mbështetja e veprimtarisë së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; ushtrimin e juridiksionit disiplinor ndaj subjekteve të përcaktuara në ligj, si dhe shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të organeve të sistemit të drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore”*.

**Qëllimi i politikës së programit:** *“Funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë si dhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi”*.

**Objektivi 1 -** *“Të shqyrtojë çështjet e ankimuar në juridiksion, bazuar në një proces të rregullt ligjor”*.

Treguesi i performancës i projektuar për të matur rezultatin e lidhur me këtë objektivi është: *“Numri i çështjeve të përfunduara në raport me numrin e çështjeve të ankimuar”*.

Për përmbushjen e misionit të tij për vitin 2024, Kolegji ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore, në bazë të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 97/2023, datë 07.12.2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe në bazë të akteve normative të dala gjatë vitit apo Vendimeve të Këshillit të Ministrave.

Ky dokument përfaqëson Raportin e Monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar, që ka në fushën e përgjegjësisë Kolegji i Posaçëm i Apelimit (Kolegji), duke ofruar informacion të detajuar mbi ecurinë e zbatimit të

buxhetit për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2024. Monitorimi i zbatimit të buxhetit për këtë periudhë përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara. Me qëllim për të kontribuar në përmbushjen e misionit dhe objektivave të institucionit, buxheti i Kolegjit është mbështetur në udhëzimet standarde të hartimit të buxhetit mbi bazë të treguesve të performancës, por gjithashtu dhe monitorimin e realizimit buxhetor mbështetur mbi ata tregues të planifikuar gjatë hartimit të Programit buxhetor afatmesëm.

## 2 RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE PËR VITIN 2024

Buxheti i Kolegjit është miratuar me ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, ku në total rezulton të jetë miratuar si plan fillestar një vlerë prej 248,900,000 lekë. Këto burime financiare, Kolegji i ka përdorur në funksion të përmbushjes së plotë të detyrimeve të miratuara me ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe vendimmarrjes së Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 02, datë 09.02.2024, për detajimin e fondeve buxhetore për vitin 2024.

Në kërkesat buxhetore për vitin 2024, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka përcaktuar si produkt kryesor për realizimin e objektivit, “Të shqyrtojë çështjet e ankimuar nën juridiksion, bazuar në një proces të rregullt ligjor”, me një plan vjetor në masën prej 70 çështje. Deri më 31.12.2024 janë realizuar 67 çështje. Në këtë parashikim është përfshirë numri i ankimeve që parashikohet të paraqiteshin gjatë vitit 2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të Juridiksionit të Rivlerësimit (JR), si dhe numri i ankimeve/kërkesave në kuadër të Juridiksionit Disiplinor (JD).

Deri në fund të muajit dhjetor 2024, situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me planin, paraqitet si më poshtë:


### RAPORTI I SHPENZIMEVE TË PROGRAMEVE SIPAS LLOGARIVE EKONOMIKE

*Në mijë lekë*

<i>Art.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Fakt 2023</i>	<i>Buxhet fillestar 2024 sipas ligjit nr. 97/2023</i>	<i>Buxhet i rishikuar 2024</i>	<i>Fakt viti 2024</i>	<i>Në %</i>
600	Paga	233,692	203,100	255,300	255,274	100%
601	Sigurime Shoqërore	17,721	20,160	20,760	20,533	99%
602	Mallra dhe Shërbime të tjera	11,720	23,640	23,040	19,030	83%



606	Trans për buxh. fam. dhe individ	889		1,250	1,009	81%
230/231	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm	954	2,000	2,000	1,289	64%
	<b>Total</b>	<b>264,976</b>	<b>248,900</b>	<b>302,350</b>	<b>297,135</b>	<b>98%</b>




## STRUKTURA E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA KUNDREJT REALIZIMIT

Duke marrë në analizë peshën e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike mbi totalin e buxhetit të Kolegjit, pjesën më të madhe të planit të shpenzimeve buxhetore e zë llogaria “Paga të personelit”, me rreth 84%, llogaria “Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, me rreth 7%, më pas llogaria “Mallra dhe shërbime të tjera”, me rreth 8%, ndërkohë që llogaria “Shpenzime kapitale” zë një peshë më të vogël, më pak se 1%.

Duke u mbështetur mbi veprimtarinë bazë të institucionit, kjo shpërndarje e planit të shpenzimeve buxhetore lidhet drejtpërdrejtë me natyrën e punës së Kolegjit. Nëse do të marrim në analizë peshën e llogarive ekonomike, ndërmjet atyre të planifikuara dhe të realizuara, evidentohet një ruajtje e peshës së këtyre shpenzimeve, si në buxhetin e planifikuar, ashtu edhe në atë të realizuar për vitin 2024.

Gjatë vitit 2024 është synuar përdorimi me eficiencë dhe efektivitet maksimal i burimeve financiare, në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe në vijim synohet konsolidimi financiar dhe

administrativ i institucionit, me qëllim realizimin e treguesve të performancës, të përcaktuar në Programin buxhetor afatmesëm 2025-2027.



## 2.1 INFORMACION MBI VOLUMIN DHE MADHËSINË E NDRYSHIMIT TË BUXHETIT

Për vitin 2024, buxheti i miratuar sipas ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr.1, datë 24.01.2024, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, ishte në vlerën 248,900,000 lekë. Gjatë vitit, ky buxhet pësoi ndryshime, të cilat konsistojnë në shtesa dhe rialokime të renditura si më poshtë:

- Çelje e fondit të veçantë, sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr. 534, datë 09.02.2024, protokolluar në Kolegj me nr. 145/1 prot., datë 13.02.2024;
- Transferim fondi sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr. 687/1, datë 09.02.2024, protokolluar në Kolegj me nr. 161/1 prot., datë 13.02.2024;
- Shtesë fondi në artikullin 600, “Shpenzime personeli”, bazuar në Aktin Normativ nr. 3, datë 28.08.2024;
- Shtesë fondi në artikujt 600/601, “Shpenzime personeli”, sipas VKM-së nr. 421, datë 26.06.2024;
- Shtesë fondi në artikujt 600/601, “Shpenzime personeli”, dhe 602, “Shpenzime operative, bazuar në Aktin Normativ nr. 5, datë 19.12.2024;

- Transferim fondi sipas shkresës drejtuar Ministrisë së Financave nr. 1338, datë 31.12.2024.

## Rishikimi i fondeve buxhetore

Në mijë lekë

Llog. ekonomike	Plani fillestar (ligji nr. 97/2023)	Rialokim për shpenzimet celulare	Shtesa nga fond i veçantë	Shtesë sipas AN nr. 3	Shtesë sipas VKM-së 421, datë 26.06.2024	Shtesë sipas AN nr. 5	Rialokim	Plan i rishikuar
600	203,100	0	0	28,000	1,300	19,600	3,300	255,300
601	20,160	0	0		200	400		20,760
602	23,640	-1,000	0	3700	0		-3300	23,040
606	0	1,000	250	0	0			1,250
231	2,000	0	0	0	0			2,000
<b>Total</b>	<b>248,900</b>	<b>0</b>	<b>250</b>	<b>31,700</b>	<b>1,500</b>	<b>20,000</b>	<b>0</b>	<b>302,350</b>

## ANALIZA FINANCIARE ANALITIKE

Të analizuara sipas llogarive ekonomike analitike, shpenzimet buxhetore paraqiten në vijim:

### 2.1.1 Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)

Fondet e miratuara në fillim të vitit, me ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, kanë qenë në vlerën 203.1 milionë lekë, ndërkohë që sipas planit të rishikuar vjetor, janë në vlerën e 255.3 milionë lekë. Ky buxhet është realizuar në vlerë 255,3 milionë lekë ose 100% e planit të rishikuar të vitit 2024. Buxheti i rishikuar përbën 84% të buxhetit total vjetor, ndërsa realizimi për këtë artikull zë 86% të buxhetit total, të përdorur për 12-mujorin.

Ky buxhet është përdorur gjatë vitit për mbulimin e detyrimeve ligjore në fushën e pagave dhe sigurimeve shoqërore, për Gjyqtarët, Këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, si dhe punonjësit administrativë të Kolegjit. Me buxhetin shtesë, miratuar me Aktin Normativ nr. 3/2024 dhe nr. 5/2024, u realizua likuidimi i plotë i detyrimeve që lidheshin me efektin prapaveprues të rilogaritjes së pagës së Gjyqtarëve dhe Këshilltarëve të Njësisë së Shërbimit Ligjor, në zbatim të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nr. 35, datë 22.11.2022.



Numri mesatar i punonjësve për 12-mujorin 2024, është 62 punonjës. Numri i punonjësve në organikë, i planifikuar për vitin 2024, ishte 57 punonjës dhe, pas miratimit të strukturës së re, me vendimin e Kuvendit nr. 35/2024, datë 11.04.2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 ‘Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit’ ”, ky numër arriti në 63 punonjës. Në fund të periudhës 12-mujore, numri faktik i punonjësve në Kolegj ishte 61 punonjës.

Sipas VKM-së nr. 39, datë 24.01.2024, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024, në njësitë e qeverisjes qendrore”, u miratua një numër shtesë prej 7 punonjësish me kontratë të përkohshme, me kohë të pjesshme pune (6 orë/ditë), të cilët, me miratimin e vendimit të Kuvendit nr. 35/2024, kanë kaluar me kohë të plotë. Për periudhën qershor – dhjetor 2024 ka qenë vetëm një punonjës me kohë të pjesshme pune.

### **2.1.2 Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601)**

Fondet e miratuara në fillim të vitit, me ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, janë në vlerën 20.2 milion lekë, sipas planit të rishikuar vjetor janë në vlerën e 20,76 milionë lekë dhe realizuar në masën 99% të buxhetit total. Buxheti i rishikuar për vitin 2024 përbën 7% të buxhetit total vjetor. Fondi për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është i lidhur me marrëdhëniet e punësimit dhe, si rrjedhojë, argumentet që lidhen me fondin e pagave, vlejnë edhe për këtë zë buxhetor.

### **2.1.3 Shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera (llogaria ekonomike 602)**

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për materiale dhe shërbime të domosdoshme për mbështetjen e veprimtarisë institucionale operacionale. Shpenzimet për këtë zë, zënë 8% të shpenzimeve totale vjetore.

Fondet e miratuara në fillim të periudhës për këtë zë, me ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, kanë qenë në vlerën e 23.6 milionë lekë dhe buxheti i rishikuar, në vlerën 23.04 milionë lekë.

Rishikimet e buxhetit në këtë zë konsistojnë në:

- Transferimin e një fondit në vlerë 1 milion lekë nga artikulli 602, “Mallra dhe shërbime të tjera”, në artikullin 606, “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”, për mbulimin e shpenzimeve telefonike për kontratat individuale të Gjyqtarëve dhe Këshilltareve të Kolegjit, bazuar në VKM-në nr. 855, datë 02.11.2020 dhe Vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 28, datë 21.12.2020.
- Shtesën e fondit, miratuar me Aktin Normativ nr. 3/2024, në një vlerë prej 3.7 milionë lekë dhe transferimit të fondit në vlerë 3.3 milionë lekë nga artikulli 602, “Mallra dhe shërbime të tjera”, në artikullin 600, “Shpenzime personeli”.



Buxheti i detajuar në shpenzime operative, për vitin 2024, është realizuar në vlerën 19 milionë lekë nga 23 milionë lekë të planifikuara, ose në masën 83%. Në mënyrë të detajuar shpenzimet për mallra dhe shërbime paraqiten në tabelën në vijim.

Në mijë lekë

<i>N/artik.</i>	<i>Struktura e llogarive</i>	<i>Plan vjetor</i>	<i>Fakt progresiv 12-mujor</i>
<b>602</b>	<b><i>Mallra dhe shërbime të tjera</i></b>	<b>23,040,000</b>	<b>19,029,844</b>
1	Materiale zyre dhe të përgjithshme	1,040,000	1,000,350
2	Materiale dhe shërbime speciale	1,465,000	861,145
3	Shërbime nga të tretë	3,443,000	3,076,190
4	Shpenzime transporti	520,000	498,882
5	Shpenzime udhëtimi	630,000	176,027
6	Mirëmbajtje të zakonshme	1,255,000	278,000
7	Shpenzime për qiramarrje	1,547,000	1,547,000
8	Shpenzime të tjera operative	12,740,000	11,592,250

Gjatë periudhës 12-mujore janë kryer pagesa për të shlyer detyrimet bazuar në kontratat dhe faturat, sipas procedurave përkatëse. Shpenzimet janë realizuar për pagesat e detyrimeve utilitare dhe detyrime prioritare: si energji elektrike, ujë, shërbime postare, si dhe taksa blerje karburanti, shlyerja e detyrimeve kontraktuale, prokurimet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve.

### ***2.1.3.1 Materiale zyre dhe të përgjithshme***

Në këtë nënartikull buxhetor përfshihen shpenzimet materiale për: kancelari, materiale higjieno-sanitare, materiale elektrike dhe artikuj si këto. Plani i buxhetit, i rishikuar për këtë zë, është 1.04 milionë lekë, nga i cili është përdorur një fond prej rreth 1,000 mijë lekë, për të likuiduar faturat për shpenzimet materiale, si: kancelari, materiale higjieno-sanitare etj., të kryera gjatë vitit.

### ***2.1.3.2 Materiale dhe shërbime speciale***

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzimet lidhur me abonimet në shtypin e shkruar, regjistra specifike të protokollit, kodekse, uniforma për seancat gjyqësore, dezinfektim ambientesh, pagesë tarife për OBP etj. Nga 1.465 milionë lekë të planifikuara janë përdorur rreth 861 mijë lekë ose 59% .

Në këtë zë, peshë të madhe zënë nevojat për kuti dhe dosje, për vendosjen e dokumentacionit të institucionit, të klasifikuar me afat ruajtje të përhershme, pas përpunimit të tyre. Procedura e prokurimit për kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme po kryhej nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, bazuar

në VKM nr. 360, datë 26.04.2017, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, ndryshuar me VKM-në nr. 608, datë 22.09.2022. Kjo procedurë nuk u finalizua nga DPA-ja dhe, për këtë arsye, ky fond nuk u realizua gjatë vitit.

#### **2.1.3.3 Shërbime nga të tretë**

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzimet utilitare, si energji elektrike, furnizim me ujë, shpenzime postare (postim dokumentacioni, abonim në shtypin e shkruar), telefoni fikse, si dhe publikime në media të vendeve të shpallura vakante në institucion. Peshën kryesore në këtë zë e mban nënzëri energji elektrike, me 50% të totalit të tij. Nga 3.443 milionë lekë të planifikuar, janë realizuar rreth 3.076 milionë lekë ose 89%.

#### **2.1.3.4 Shpenzime transporti**

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzimet që lidhen me pjesët e këmbimit të makinave, goma bateri, karburant, vendparkimi për automjetin e Kolegjit, si dhe siguracioni i detyruar i automjetit. Peshën kryesore në këtë zë e mban nënzëri *karburant*, me 46.6% të totalit të tij. Fondi për këto zëra është përdorur në varësi të nevojave që ka pasur riparimi ose mirëmbajtja e automjetit. Planifikimi ka qenë 520 mijë lekë dhe realizimi është në vlerën 499 mijë lekë ose 96%.

#### **2.1.3.5 Shpenzime udhëtimi**

Në këtë nënartikull janë kryer shpenzime për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit. Planifikimi për këtë zë ka qenë 630 mijë lekë dhe realizimi është 176 mijë lekë ose 28% për mbulimin e shpenzimeve për përfaqësuesit e Kolegjit, në “Takimin e 14-të të Nënkomitetit të Stabilizim-Asociimit”.

#### **2.1.3.6 Mirëmbajtje të zakonshme**

Në këtë nënartikull janë kryer shpenzime për mirëmbajtjen e sistemeve/pajisjeve TIK , të sistemit elektrik, programit financiar “Financa 5” si dhe mirëmbajtje të mjeteve të transportit. Pjesë e këtij fondi është edhe marrëveshja kuadër nr. 519/31 prot., datë 04.08.2023, lidhur midis Kolegjit dhe operatorit ekonomik “Atom” SHPK, me objekt “Mirëmbajtje për servera, kompjutera, pajisje zyre”. Buxheti i rishikuar në këtë zë është 1.255 milionë lekë dhe realizimi 278 mijë lekë, kjo për faktin se nuk ka qenë e nevojshme të kryhet një procedurë prokurimi për mirëmbajtjen e sistemeve/pajisjeve TIK.

#### **2.1.3.7 Shpenzime për qiramarrje**

Në këtë nënartikull janë kryer shpenzime për qiranë e ambienteve shtesë sipas kontratës së lidhur gjatë vitit 2023 - 2024. Plani për këtë zë shpenzimi ka qenë në vlerën 1.547 milionë lekë dhe realizimi 1,547 mijë lekë, për shkak të tarifës fikse mujore për likuidimin e kësteve të qirasë.

### **2.1.3.8 Shpenzime te tjera operative**

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzime për sigurimin e jetës, shëndetit dhe pronës, shpenzime për taksa të ndryshme, licenca *Firewall*, *Microsoft Office* dhe *Zoom Meeting* etj. Procedurat për “Blerje licencash *Firewall/Microsoft Office* dhe *Zoom Meeting*” dhe “Mirëmbajtje *website kpa.al*”, të cilat janë realizuar në periudhën gusht-tetor, sipas parashikimeve kontratuale. Procedurat e prokurimit me objekt “Sigurimi i shëndetit për Gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, personat e lidhur të Gjyqtarëve, Këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, Sekretarin e Përgjithshëm, Drejtorët e Drejtorive, stafin administrativ dhe sigurimi i pasurisë”, finalizuar me lidhjen e kontratës nr. 214/21, datë 17.10.2024, prokurimi me objekt: “Sigurimi i jetës për Gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, personat e lidhur të Gjyqtarëve, Këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorët e Drejtorive”, finalizuar me lidhjen e kontratës nr. 1018/21, datë 20.12.2024, në zbatim të VKM-së nr. 245, datë 17.04.2024, janë kryhet nga “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” SHA. Është kryer likuidimi i kontratave të mësipërme për detyrimin e vitit 2024. Fondi i rishikuar në këtë zë është 12.74 milionë lekë dhe është realizuar në masën 91%.

### **2.1.3.9 Transferta për buxhetet familjare dhe individët (Ilogaria ekonomike 606)**

Buxheti i detajuar në këtë zë është në vlerën 1.25 milionë lekë dhe realizimi në vlerën 1 milionë lekë, ose 80%. Në këtë grup përfshihet fondi i veçantë në vlerën 250 mijë lekë, miratuar me ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, si dhe fondi në vlerën 1 milion lekë për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare për Gjyqtarët dhe Këshilltarët e Kolegjit, transferuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 534 prot., datë 09.02.2024, nga artikulli 602, “Mallra dhe shërbime të tjera”, në artikullin 606, “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”.

Gjatë kësaj periudhe është kryer rimbursimi i shpenzimeve telefonike të Gjyqtarëve dhe Këshilltareve, sipas përcaktimit në VKM-në nr. 673, datë 02.09.2020, “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 28, datë 21.12.2020, të Mbledhjes së Gjyqtarëve, ndryshuar me vendimin nr. 23, datë 05.02.2021, në vlerën 889 mijë lekë.

Fondi i veçantë është përdorur për:

- Ndhimë financiare për punonjësit mbështetës të institucionit, në masën 90 mijë lekë, bazuar në VKM-në nr. 846, datë 26.12.2024, “Për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të qeverisjes qendrore”;
- Ndhimë ekonomike në rast fatkeqësie familjare, në masën 30 mijë lekë, bazuar në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”.

### **2.1.4 Shpenzimet kapitale (231)**

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2024, në investime, është 2 milionë lekë dhe përbën rreth 1% të buxhetit total vjetor të rishikuar. Këto fonde janë parashikuar për plotësimin e nevojave për punonjësit, bazuar në strukturën organike, si dhe të nevojave të tjera të institucionit për pajisje kompjuterike në vlerën 1,2 milionë lekë dhe pajisje e mobilie zyre në vlerën 800 mijë lekë. Sa i takon zërave në



investime, në Regjistrin e Parashikimit të Prokurimit Publik për vitin 2024, ato janë realizuar në pjesën e dytë të vitit, pas zhvillimit të procedurave me objekt “Blerje pajisje elektronike” dhe “Blerje pajisje dhe mobilie të ndryshme”. Realizimi në këtë zë është 65%, kjo për shkak të uljes së vlerës nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës dhe pamundësisë kohore për riprokurimin e fondit.

Në lidhje me sa më sipër, bashkëlidhur gjeni anekset për raportimin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën janar – dhjetor të vitit 2024.

Duke ju falënderuar për vëmendjen,